REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.617/2020

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Muhamet Rexha dhe Albert Zogaj ,anëtarë, në çështjen juridike të paditëses N.T.SH ‘’28 N.’’, me seli në ..., e cila është nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit-Zyra Rajonale në Gjilan, kundër të padituës N.T.P ‘’L. ‘’me seli në ... ,të cilën e përfaqëson I. R. , për shkak të pagesës së qirasë ,duke vendosur përkitazi me revizionin e të padituës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr 3003/2017 të datës 25.6.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 14.4.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të padituës , paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr 3003/2017 të datës 25.6.2020,

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr 3003/2017 të datës 25.6.2020, është refuzuar ankesa e të padituës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr 336/2013 datë 28.4.2017, me të cilën është aprovuar kërkesëpadia e paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit -Zyra Rajonale në Gjilan , si e bazuar dhe është obliguar e paditura N.T.P ‘’L.’’ me seli në ... , që paditëses në emër të qirasë duke filluar prej datës 1.10.2003 e deri më 21.7.2006 t’ia paguaj shumën në lartësi prej 26,602.45 €, për shfrytëzimin e lokalit që gjendet në Lagjen ‘’B.’’ në ... 100 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij

aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. E paditura lirohet nga shpenzimet gjyqësore .

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditëses në tërësi ose të njëjtat aktgjykime të prishen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim .
Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të provave dhe mbajtjes së shqyrtimit kryesor, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditeses si të bazuar dhe se në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është provuar fakti se e paditura e ka shfrytëzuar lokalin e N.T.SH. “28 N.” me seli në … për periudhën në periudhën prej 1.10.2003 e deri më 31.7.2006,në bazë të kontratës mbi qiranë të lidhur me nr 56 të datës 15.1.2002,lidhur në mes të paditëses N.T.SH. “28 N.” me seli në … dhe të padituës N.T.P. “L.” me seli në ….Paditësja në cilësinë e qiradhënëses i'a ka dhënë në posedim dhe shfrytëzim të padituës në cilësinë e qiramarrëses, lokalin afarist me objektet përcjellëse që gjenden në lagjen “…” në Gjilan, me qira mujore pre 631 euro, në muaj, ndërsa qiraja kërkohet nga periudha kohore prej 01.10.2003 e deri më datën 31.07.2006 në shumën prej 26.602,45 euro.

E paditura nuk e ka mohuar borxhin që e ka ndaj paditëses por ka theksuar se nuk posedon mjete financiare për ta bërë pagesën e këtij borxhi, duke qenë se është shfrytëzuese e ndihmës sociale. Me rastin e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin 567 dhe 583 të Ligjit mb Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD). Në raport me shpenzimet procedurale, gjykata e shkallë së parë ka vendosur duke u bazuar në nenin 468 të LPK.
Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore, ka refuzuar ankesën e të padituës dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi një qëndrim të tillë të gjykatave të instancës më të ulët, pasi që aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me

shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike rezulton se drejtë kanë vendosur gjykatat e instancës ma të ultë kur kanë gjetur se kërkesa e paditëses për pagimin e qirasë për periodën prej 1.10.2003 e deri më 31.7.2006 është e bazuar , nga se me nenin 567 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve është e përcaktuar "me kontratën e qirasë obligohet huadhënësi që t'i dorëzojë sendin e qiramarrësit në përdorim, ndërsa ky obligohet t'i paguajë për këtë qiranë e caktuar" ndërsa me nenin 583 të njëjtit ligj ceket se „*qiramarrësi ka për detyrë ta paguajë qiranë e caktuar me kontratë ose me ligj e në mungesë të kontratës dhe të ligjit, ashtu si praktikohet në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit*".

Pretendimet e paraqitura në revizion për shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (f) të LPK, që kanë të bëjnë me atë se për të vendosur në këtë çështje juridike është kompetente Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme , nuk qëndrojnë , kjo për shkak se me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës E.nr.12/2012 datë 06.11.20212, është caktuar kompetenca lëndore e Gjykatës Themelore në Gjilan dhe se kjo kompetencë lëndore është përcaktuar me nenin 26 par.1 pika 13 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta (Gazeta Zyrtare KSAK nr.2178).

E paditura pretendon se paditësja nuk ka legjitimitet për tu paraqitur si paditës, për shkak se në me nenin 2.1 të Rregullores mbi Themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës nr.2002/12 e cila ka qenë në fuqi është përcaktuar se Agjencia administron me ndërmarrjet në pronësinë publike dhe shoqërore dhe me pasurinë e tyre e që kjo është paraparë edhe me nenin 5 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (nr.04/L-034), prandaj pretendimet e të paditurës në këtë drejtim janë të pathemelta.

Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së të paditurës ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore për të cilat ka dhënë arsye bindëse të cilat janë të pranuara edhe nga Gjykata Supreme dhe se pretendimet e të paditurës se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe se nuk ekzistojnë fare arsyet për faktet vendimtare janë të pabazuara.

Pavarësisht nga fakti se ai nënshtrohet ndërmarrja procedurës së likuidimit nuk e përjashton mundësinë që AKP-ja të realizojë kërkesat e ndërmarrjes që ka në administrim ndaj palëve të treta si dhe në rastin konkret ndaj të padituës , ku e paditura në bazë të kontratës mbi qira nuk ka përmbushur detyrimet ndaj ndërmarrjes publike NSHT "28 N." në ... e cila është në administrim të AKP-së.Thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike është dashtë të pezullojë procedurën nuk qëndrojnë.

Nga arsyet e dhëna më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.617/2020 , me 14.prill . 2020

Kryetar i kolegjit,

Erdogan Haxhibeqiri